


# A do të jetë gati fëmija juaj për në kopësht?



## Ndihmojeni fëmijën tuaj për sukses në shkollë

Të jesh “gati” do të thotë më shumë se të numërosh dhe të thuash alfabetin

- A e di fëmija juaj që shkronjat kanë zë?
- A e di ai/ajo se fjalët janë bërë prej këtyre shkronjave?
- Ai/ajo numëron deri në 10, po a e di kuptimin e “më shumë se” dhe “më pak se”?

**Flitni me fëmijën tuaj në çdo rast që ju paraqitet!**

## Bëni këto 10 gjëra çdo ditë!

1. I tregoni atij që edhe ju gjithashtu mësoni. Tregoni çfarë keni mësuar sot.
2. Nxiteni atë të provojë diçka të re dhe e ndihmoni të jetë i /e suksesshme.
3. Në kohën e gjumit i lexoni një tregim dhe e diskutoni atë. Cila është pjesa e tij/saj më e pëlqyer? Pse?
4. Duke shëtitur, vështroni shënjat dhe dalloni shkronjat dhe tingujt e tyre.
5. Rrotull shtëpisë, sipas mënyrës së tij/saj sistemoni gjëra të ndryshme si lugë, pirunj, monedha, ose rroba
6. Në automjet, ose në dyqan emërtoni çdo ditë gjëra të reja. Vështroni për numra dhe flisni çfarë kuptimi kanë.
7. E dëgjoni atë për çka mendon, njeh, ose dëshiron të njohë.
8. Kufizoni kohën në televizor dhe nxiteni të ndërtojë lojra të veta.
9. Tregojini për pikat e forta të tij/saj dhe i ofroni sfida bazuar në forcat e tij/saj.
10. Tregojini që ju e doni, i qëndroni pranë dhe i thoni tre gjëra pozitive, për çdo negative.



# Si po ecën fëmija im?

Aftësitë që kërkojnë mësuesit e kopështit:

<b>Sociale dhe Emocionale</b>	Akoma jo	Disa herë	Zakonisht
1. Shpreh siç duhet ndjenjat sipas situatave			
2. Njeh preferencat dhe aftësitë e veta			
3. Mund të ofrojë zgjidhje të thjeshta për konfliktin			
4. Mund të ndjekë rregullat dhe rutinën			
<b>Gjuhësore</b>			
5. Njeh 8-12 shkronja ( shkronja të mëdha dhe të vogla)			
6. Njeh emrat, ose fjalët e tjera të printuara			
7. Bën tingullin fillestar në fjalët e shkurtëra			
8. Përputh 6-10 shkronja me tingullin e tyre			
9. Mban mend detaje nga ndodhitë			
10. Përdor pikturat dhe mbështjellësen librit për të folur rreth librave			
11. Shkruan emrin me shumicën e shkronjave saktë			
12. Planifikon dhe tregon, vizaton ose shkruan një ndodhi			
13. Flet me fjali të kuptueshme			
14. Përgjigjet saktësisht ndaj udhëzimeve dhe pyetjeve			
15. Flet me të rriturit e familjes dhe shokët			
16. Përdor Anglishte të mirë në bisedim			
<b>Matematikë</b>			
17. Numëron deri në 20			
18. Njeh numrat e shkruara nga 1 në 10			
19. Kupton mbledhjet dhe zbritjet e thjeshta			
20. Emërton katrorët, këndet, rrathët, trekëndëshat dhe katërkëndëshat			
21. Përshkruan rendin e objekteve (i pari, ai që vijon)			
22. Krahason dy objekte (më i madh, më i gjatë, më i rëndë)			
23. Dallon llojet, numëron dhe krahason sasi të			
<b>Qasjet në Mësim</b>			
24. Tregon interes për përvojat e reja			
25. Vepron ndaj linjave të njohura të një tregimi, jep, ose futet në rolet			
26. Vepron në aktivitetet e zgjedhura edhe kur ato vështirësohen			
27. Ndan detyrën në faza dhe i kryen ato njëra pas tjetrës			
28. Përpiqet të zgjidhë problemet në rrugë të ndryshme, merr ndihmën e nevojshme			
<b>Fizike</b>			
29. manovron me objekte të vogla			
30. Ka siguri në lëvizjen e të gjithë trupit			